

8JH-1  
M 78

BESNIK  
MUSTAFAJ

# Fytyrë burri

---




814-1  
M 98

Besnik  
Mustafaj



Fytyrë  
burri  
POEZI



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

# Abetarja

Aty ku duhej të mbaronte botë e  
përrallave,  
aty u shfaqe ti.

Sepse ne s'duhej të mbeteshim gjithmonë  
fëmijë...

Për të mos humbur, për të mos u rrëzuar  
në të përpjetat ku do të na ngjisje ti,  
në faqen e parë, me buzë në gaz,  
na priti Enveri...

## Unë jam pjesë e rrugës sime

Eci në rrugën që kam nisur. Gjymtyrët e mi lëvizin natyrshëm, në harmoni të plotë me ndërrimin e shpeshtë të peizazhit, me ndërrimin kalendarik të stinëve, me ndërrimin e papritur të motit; në harmoni të plotë me fytyrat e bashkëkohësve që më kalojnë në krahë.

Rrobat s'mi bëhen dot trupit maskë!

Ju flas juve që më njihni; ju lutem, në më doni vërtet, mos më kërkonitë njëtrajtshëm, s'mund të jem i tillë!

Në ecje bart në vete pak nga ikja e verës,  
i jap asaj si dhuratë e si peng  
dhimbjen e ditës që mylllet,

iku duke lënë tek unë  
monumentin e punës së vet të pavdekshme;  
sic ia marrsh kujdesjen lumit, seriozitetin  
malit,  
pa ngurrim ia lë rininë time një nëne  
dëshmori  
që me sy të rrëmbushur më thërret «bir».

Fytyrën e kam pasqyrë të dashurive të  
gjakut.

Më shihni si qesh e si vrenjtem, lavdëroj e  
shaj.

qëndron e njëllë sëritët qëndrueshëm  
gjithçka është e bëjshëm që ka  
dallimin e përsëritë e mësimdhënsh

Sunt doctoressa studi ule  
principale huiusmodi utrumque præceptum  
et sententiam illam respondeat dicitur ut pia  
alium.

subi huiusmodi sunt omnia qæ si misteriora ne  
comprendit

videt doctoressa ratiocinatione ut ipso sit

*Mos ju ngjaj i panatyrshëm??  
Jam si bota përreth, si stinët, si peizazhi, si  
moti,  
eci e i bart në vete të gjitha: të keqen e  
vdekshme  
e të mirën që shkon para,*

*gëzimin e dhimbjen e lindjes, dashurinë  
dhe urejtjen.*

*Ndaj, ju flas edhe juve që s'më njihni,  
në më doni vërtet,  
mos më kërkonitë njëtrajtshëm, jam si  
rruga ku eci,  
me trup të zakonshëm si dheu  
e njëkohësisht të ylbertë.*

# Skicë nga një pasdite dimri në Kurbnesh

Bën ftohtë, shumë ftohtë.  
Edhe duke ndenjur  
e ndien nevojën e shokut.  
Dy duar s'e mbështillkan dot njëra-tjetrën,  
as nga era dy duar  
s'të mbrokan dot.

...Minatorët nga katër e nga pesë  
hyjnë e dalin në kafe...  
Me krismën e të qeshurës së çlirët  
ia thyejnë ditës akullin...

# Këngë dashurie në vjeshtë

sipas ritit të lashtë

*Si ndodhi kështu?!*

*I thonë vjeshtë e dytë,  
po vjeshta nuk duket askund;  
as gjethe të rëna,  
as bar i tharë,  
as re.*

*Në vjeshtë si në vjeshtë:  
duhet patjetër diçka,  
e mrekulluar prej bukurisë së vet,  
të vdesë.*

*Sonte ky jam unë.  
E pashë, e pashë, e pashë  
varrin tim të madh në sytë e tu.*

*Të lutem, e dashur, thuaju njerëzve  
s'i erdhi vdekja, e thirri ai.  
I mrekulluar nga çasti kur ishim bashkë  
shkoi vetë t'i bëhej vjeshtës kurban.*

# Lulet prej letre

kundër artit ornamentalist

*Lulet prej letre: të kuqe, të verdha.*

Në ngjyrat e tyre s'është dielli,  
s'është dheu, s'është shiu, s'është vesa,  
s'është dita as nata,  
s'është hijedrita e reve,  
s'është kufiri i pacaktuar mes stinëve,  
as lulëzimi  
për të mësuar se s'janë thjesht lule,  
as formimi i mundimshëm i frutit  
ku zbulohet dashuria e vërtetë e njerëzve,  
as fara për të kuptuar gjëzimin e dhimbshëm  
të nënës  
që pa ngurrim vetëmohohet  
dhe trupin e saj

# Historie S'rikrijohet

e bën udhë tē sigurt pér tē ardhur e  
nesermja.

Lule... jo,  
letra tē prera.  
Natyra s'rikrijohet me gjéra tē vdekura.

# Histori e Shqipërisë

«Shqipëri me yll në ballë»  
— popullore —

Ku ishte e fshehta?  
Djemtë me yll në ballë prisnin koka  
kuçedrash e mbretërish  
dhe vdisnin prej një gote helmi;  
vashat me yll në ballë,  
të mbyllura nëpër kthinat e errëta të  
shtrigave,  
ishin lindur për t'u bërë nuset e qerosëve.  
Sa kujtohej se sollën lumturinë  
në stanet e qerosëve-barinj,  
shndërroheshin në qyqe  
nga magjitet e fshehura në themelet e  
shtëpive.

Në zjarrminë e mbrëmjeve pa dritë e pa  
bukë  
këto krijesa i lindte vetë shpresa e njerëzve.

Prej kësaj èndrre të bukur  
diçka mbetej të nesërmen,  
diçka që rritej nga dita në ditë, nga viti  
në vit,  
diçka që përcillej prej syve të baballarëve  
te bijtë  
dhe u mbruhej në shpirt,  
i përgatiste pak nga pak të bënин  
nga ylli fluturues i fatit të përfytyruar  
te njeriu real me yll në ballë.

...Historia pas 8 Nëntorit njihet:  
emrin e Enver Hoxhës ka.

## Fjalë babai

*Ti je kaq i vogël  
sa botës njësoj ia shpreh — me të qara —  
fjalën e mirë dhe ankimin.  
Syri yt nuk shquan më shumë se tri  
ngjyra;  
si nga bishti i maces,  
gënjelesh  
dhe nga një rrëze e brishtë dielli  
që vidhet përmes perdes.*

*Besoj se të gjithë burrat, të bërë baballarë  
kështu së pari janë hutuar.  
Ç'po ndodh, kanë pyetur, ç'po ndodh?!*

*Kjo foshnjë,  
sot për sot e aftë vetëm të më lërë pa  
gjumë,*

është më e madhe se unë  
derisa është im bir  
e mua më ka baba.

Duhet zmadhuar bota përt'i bërë vend.

**1984**

## Intime

*Shumë ditë e shumë net i ndava përgjysmë  
me ty,  
shumë ditë e shumë net i jetova dyfish  
me ty,  
shumë ditë e shumë net unë heshta për  
të folur ti,  
shumë ditë e shumë net unë fola për të  
mos heshtur ti.*

*Shumë ditë e shumë net... shumë,  
s'u likan dot prapa...*

## Para pasqyrës

Para pasqyrës


vonesën më të gjatë e kam  
kur hetoj rrudhat e fytyrës,  
rrallimin e flokëve, shpeshtimin e thinjave  
në témtha.

Mëngjes për mëngjes  
pasqyra më bën një prerje të rrafshëtë në  
eshtra,

rrathët e moshës m'i shkruan  
në globin e ujshëm të syrit,  
më ngjall e ma përcjell deri në dhimbje  
të vërtetën e lashtë tragjike të jetës së  
Narcisit.

Narcisi kish ambicie të madhe  
t'u linte njerëzve diçka të mirë,  
diçka të pavdekshme.

Kur një ditë pa fytyrën e vet  
prej viteve të shndërruar krejt,



*pasqyrë para shpirtit nxori atë që kishte  
bërë:  
në të nuk dukej asgjë, e kish mundur  
kotësia.*

*Njeri i mirë ai, s'kish dashur të rronte  
i tillë;  
nga mospërputhja eëndërrës me veprën  
nëpër dejet e kaltra të trupit,  
prej hidhërimit,  
zemra i derdhi jo gjak, helm.*

*Kjo i ndodhi Narcisit dy mijë e ca vjet  
të shkuara,  
kur s'kish ku ta shihte veten qoftë edhe  
një herë më parë.*

*Dhe unë, mëngjes për mëngjes,  
bëhem gati për ditën e re  
që gjithnjë ta kem një fjalë të bukur t'ia  
them vetes  
para se ta filloj të nesërmend...*

## Të vërteta të thjeshta

Unë them se tani e shoh të paarritshmen,  
rend pas saj i dashuruar si kurrë më parë.  
— U rritëm, — thotë shoku im.

Në rendje më dhembin sytë e kraharori;  
zgjerojen, zgjerojen,  
e prapë për vogëlsirat  
ka gjithnjë e më pak vend.

## Vdekja e gjyshit

Jemi mbledhur tërë të dashurit e tu:  
gjyshja, dita e blertë e prillit, babai, nëna,  
era e ngrohtë që sjell shi për grurin,  
nusja ime me èndrrën tënde ende të  
pakryer

të të bëjë stërgjysh,  
dy vellezërit e mi dhe unë.

Ka ardhur halla me burrë e fëmijë,  
kanë ardhur sythat e hardhisë  
e gjithë shokët e tu, tanët e miqtë.

Ne, të dashuri e tu, jemi mbledhur të  
gjithë.

Të rrimë përreth  
dhe ti që kurrë s'na ke parë kaq të heshtur,  
ti që heshtjen e quaje përrallë të vjetëruar  
gjumi,  
tani rri e hesht vetë,  
nuk ngre një gisht të na bësh shenjë,  
s'lëviz një qerpik.

*Me sytë pulitur, me trup tē drejtuar,  
(deri sot unë gjithnjë tē dija pak tē  
kërrusur),  
me duar tē ngrira në tē qepurën e  
pantallonave  
sikur i je gatitur dikujt.*

S'të shoh dot ashtu, aq të bindur,  
aq të urtë;  
ti rrojte në këtë dhë të na urdhëroje ne,  
të tjerët,  
e ne të bindeshim,  
ne para teje rrinim kokulur.

Dua tē tē pyes, tē zemrohem keq me ty  
po inati e zéri mē mbyten nē grykë.  
E ndiej, dička e fortē tē mban,  
nga mundimi pér t'i ikur je zverdhur krejt.

1983-1986

## Sot

Sot u gdhiva me një shije luleshtrydhesh  
në buzë.

Ndoshta ma lanë ëndrrat e mbrëmshme,  
ndoshta diell i bukur që çeli ditën e re,  
po mua më mbeti gjatë në buzë ajo shije e  
rrallë.

Putha gruan t'i jepja pak prej saj,  
putha djalin;  
nuk di dhashë e mora  
tërë trupin ma mbushi kundërmimi i saj.

# Shkak për të të dashur më shumë

Më mori malli për ty, m'u rëndua aq  
shumë,

sa s'e mbaja më dot vetë.

Nëpër sytë pak të mjegullt  
ia përcolla një reje të bardhë në qiell.

Reja papritur u zbukurua  
si vajzë e porsadashuruar  
dhe aty për aty u shndërrua në shi  
t'ia falte tokës bukurinë e saj.

Toka e mori,

s'e mbajti për vete,  
ma dha mua  
dhe unë ndjeva të bëhem prej saj më i  
mirë.

Më mori malli për ty, m'u rëndua aq  
shumë,

*sa m'u duk e vogël shtëpia, dola në rrugë.  
Aty gjeta një shok. Dita përpëlitez midis  
vetullave të tij,*

*as ikte dot, as bëhej e tëra dritë.  
Diç munda t'i them, e lehtësova,  
nga vetullat e mbyllura ia zhburgosa ditën.*

*Shoku më desh si kurrë ndonjëherë.  
Dhe dihet:*

*dashuri e shokut të bën gjithnjë më të  
mirë.*

*Më mori malli për ty, m'u rëndua aq  
shumë,  
sa nuk duroja dot  
e desha ta ndaj me njerëzit përreth.*

*Por befas u stepa:*

*pranë meje kalonte një njeri i lig  
e unë desh ia besova një çast  
mallin për ty.*

*Të gjitha këto*

*dhe plot gjëra të tjera ngajeta e sotme,  
bashkë me këtë vjershë që shkrova tanit  
në mbrëmje  
janë një shkak  
të të dua më tepër.*

# Don Kishotit

Të dua ashtu siç je, me kalin e shpatën  
ngjeshur.  
Në bëmat e tua s'ka asgjë prej Krishti  
as prej Jude;  
bëmat e tua janë të ndershme.

Nuk qesh dot kur të shoh me fytyrë të  
gërvishtur  
e uniformë të shqyer  
prej ndeshjes së pafajshme me mullinjtë  
e erës, nuk qesh dot.  
E di, pa u trembur do të suleshe ti  
dhe po të të dilnin përpara ciklopë  
vetëm për të bërë diçka që të të afronte  
më shumë me Dylqinjën.  
Vetëmohimi yt njerëzor deri në fund!  
Dashuria fitohet. Kush s'është i zoti,  
vdektë pa dashruar!

Këtu e vendose vetë gurin e kufirit,  
i shtyve njerëzit të nxjerrin çfarë fshehin  
në shpirt  
para provës në qeshin a trishtohen  
me fatin e bëmave të tua.

## Rritja

Qytetit tim tē lindjes; B. Currit

Moshatari im.

Fëmijëria jote —

kinemaja e vogël me dërrasa pishe,  
në fëmijërinë tënde —  
fëmijëria ime duke parë film.

Si dy binjakë u rritëm.

Nëpër fotografitë me ngjyra tē revistave,  
që sillte babai në shtëpi,  
unë shpesh shihja qytete tē mëdha  
me bulevardë tē gjera,

parqe arkeologjike,  
teatro,  
statuja.

*me njerëz shumë e me shumë vutura.  
Nga një trishtim i pakuptimtë që ndieja  
për rrugët e tua,  
e urdhëroja veten të mos i pëlqej.*

*Shumë vite më vonë, tani,  
kur te ti kthehem gjithnjë e më rrallë,  
mysafir,  
nisa t'i kuptoj mbrëmjet e tua të dikurshme  
me muzgjet e heshtura jo si muzgje  
qytetesh,  
po as si muzgje fshattrash nuk ishin,  
siç ishin edhe rrobat e mia:  
triko sintetike, pantallona kadife, opinga,  
diç kisha e diç nuk kisha për t'u dukur  
fëmijë nëpunësi;  
ndaj, edhe më shumë se prej varfërisë,  
prej kësaj të dhimbshesa.*

*E ja ku u rritëm.  
Me njëri-tjetrin përsëri ngajmë si binjakë.*

*Do të rritemi prapë.*

**1976-1986**

## **Edhe me ne si me të gjithë**

... Lojë e papërmabjatur ëndërrimtare  
dhe pakëz përfytyrim,  
inat i paqenë për të mbytur drojtjen,  
fjalë të menduara më parë që harrohen,  
fjalë të reja që s'di nga dalin  
ashtu pa kuptim.

Shkujdesje e shtirur për t'u bërë guximtar,  
kalorës donkishot që i hip kalit së prapthi,  
gëzohet e zemërohet me të qeshurën e tij...

Po, e dashur, edhe me ne ndodhi si me të  
gjithë.

# Këngë për veten

Jam njëzet e pesë vjeç.

Në moshën kur rrëth syve,  
vështrimi i ngulur mbi faqen e botës  
bën rrudha të vogla.

Për të hyrë më thellë,

për të shkuar më larg  
duhet parë se ç'fshihet në zemrën e saj.

Ky harrim i vëmendshëm mbi gjërat e  
mëdha nuk erdhi tek unë befas sot.

Bashkë me numrat e ndërruar të këpucëve,  
pantallonave të shkurtra,

këmishëve të ngushta  
çdo viti që iku i lashë fytyrën time imazh.  
Kur një nga një më braktisën lodrat e  
thjeshta nisa të luaj me gurët dhe tokën.

Pastaj erdhi koha të flas me erën,  
me shiun e gjethet e pemëve.  
Gjuha ime përsosej, përsosej pak e nga  
pak.

Ditë pas dite, vit pas viti  
në rrugët që shplekste oborri i shtëpisë  
më rëndë i ndieja të më kumbonin hapat.  
Mbërthyer në pyetje tërheqja pas vetes  
gjithçka më dilte pérpara.

Dhe gjuha përsosej, përsosej  
në mundimin të shprehë deri në fund  
vetëm urejtjen dhe dashuritë njerëzore.

Sa herë kujtoja se lodrat  
mbetën diku larg,  
në fëmijëri  
dhe loti nostal gjik afrohej te syri,  
ato lëviznin brenda meje, më thoshin një  
fjalë:

— Ne s'ikim, s'të lëmë.  
Prej nesh, si prej detit që s'fle,  
dalin dëshirat e reja e rriten.

*E tani njëzet e pesë vjeç.*

*Me rrudha të vogla rreth syve,  
Në imazhin që jap për vitet që ikin  
s'lë rrudhat e vogla*  
*as thinjat,  
lë vështrimin që rend drejt zemrës së  
tokës e qiejve,  
lë shpirtin.*

*... Dhe eci, eci, eci;  
ende jam në fillimin e jetës.*

**1983**

## Si fëmijët

Si fëmijët, e dashur,  
si fëmijët e mitur jemi të dy,  
si fëmijët që hipin në një fije peri,  
kalojnë nëpër tehun e briskut  
e kur u thërrasin  
prapë s'kthehen mbrapsht.

Si fëmijët, e dashur,  
si fëmijët e mitur u bëmë të dy...

## Në rrugë

Syri e lëshon dritën te hapat  
dhe hapat masin mëngjesin.

Ja, ky i sotmi më dha pak trishtim  
me bukurinë e një vajze  
që më nxori përpara;  
ika shpejt, pa e kthyer kokën pas.

Kush tjetër mund të të bëjë  
ta nisësh ditën kaq bukur  
veç rrugës?!

Kalimtarë të nxituar, mos e hidhni në  
rrugë  
as fijen e djegur të shkrepse!  
Bujaria e fytyrave të panjohura  
të njëri-tjetrit  
duhet nderuar.

... Dhe syri e shton dritën te hapat,  
dhe hapat ia masin ngeshëm  
bukurinë mëngjesit.

Besoj te dashuria e njeraut per' punën e  
Besa,  
Irisi i kësaj dashurie përmes fjalitë —  
ar nesiq se tau e simollou studiuesit  
tau volejti përcasët këshiu, njeri u poqet  
me treg

... me bishet mid zot i lumenja simollje të  
Kosova qëndruesit, që përdorim me atë  
dhe pasur kurre udorejt themelën magjike.  
Por qen Akili e Kësive velem ta frashet,  
në formë të tillë që jemi qëndruam ose  
tashë është edhe qëndrim qëndruam ose  
në formë e qëndruesit, qëndruam ose  
në formë e qëndruesit, qëndruam ose

... qëndruesit, magjika  
Homerti e agjodhurave si figurat, erësive  
poetike

# Gjimnazistja që shkruan vjetështinë

Nëna mburr vëllanë e vet se punon në  
komitet.

Për vëllanë e vogël  
daja te makina e ka madhështinë.

Ajo vetë kujton gjithnjë disa ditë të largëta  
kur daja ishte mësues gjuhe në fshat  
dhe shpesh të dielave, me shkrimitarin  
Jakov Xoxa  
shkonin tutje, nga pylli për gjah.

## Motiv i përditshëm

Besoj te dashuria e njeriut për punën që  
bën,  
fryt' i kësaj dashurie përsoset përditë —  
mrekulli!  
Vetë bota përsoset kështu, njeriu bëhet  
më trim,

sepse bëhet më zot i duarve të tij.  
Dhe kaq mjafton për të kuptuar se Akili  
s'ka pasur kurrë ndonjë thembër magjike.  
Forcën Akili e kishte vetëm te krahët,  
te shkathtësia për të zotëruar ushtën e  
shpatën.

S'pat lindur i tillë, u bë;  
unë e di, i janë dashur muaj e vite  
stërvitje

Thembrën magjike  
Homéri e zgjodhi veç si figurë të rrallë  
poetike

p r t'ua th n  njer zve sa m  bukur,  
sa m  bukur t'i joshte te mendimi:  
nuk ka asgj  t  paarritshme...

## Borxhi i babait

Rruja, fleta e bardhë ku shkruaj,  
m jegulla e mbrëmjes,  
përkëdhelja intime e gruas,  
mëngjesi me dritë të kulluar,  
korja e pjekur e bukës  
si lëkurë pëllëmbe e burrit,  
dera e çelur e shtëpisë,  
këpucët me thembra të ngrëna,  
tavolina e zyrës, belbëzimet e djalit,  
dielli i mesditës,  
replikat me shefin, shiu i verës,  
pikëpjekjet me shokët  
dhe shumë e shumë gjëra të tjera  
që mbushin jetën time  
përveç lidhjes së tyre të përgjithshme  
kanë edhe një lidhje të vetën.

Ati im që je larg, me ç'postë të ta dërgoj  
pjesën që të takon nga gëzimet e dështimet  
e mia?!

## Teatri i kukullave

*Aty, kukullat-karikatura të bukura  
kafshësh —  
flasin me zë njeriu,  
punojnë, thurin intriga,  
dhe sipas kalkulimit ekzakt të atyre që u  
japin zërin  
të ligjtë bien patjetër në lak në aktin  
e fundit të pjesës,*

*të mirët  
u japin dënim kapital  
nën brohorima e tinguj marshi triumfal.*

*Unë e çoj djalin aty të mësojë që tani  
se jo vetëm ujku, jo vetëm dhelpa,  
po edhe ai druri i plepit që duket i butë  
e krejt memec*

dhe gjithnjë zbardhon, si nën dritë dielli,  
 si nën dritë hëne,  
 pa kundërshtuar kurrë, i bindet gjithkujt,  
 bash te nënshtrimi i vet e ka përherë një  
 pabesi.

*Le ta shohë djali  
sejeta e pyllit nuk është kurre kaq e qetë  
sa ç'duket kur shëtit nëpër të të dielave,  
apo mbledh lule farfuritëse lëndinave të tij.*

# Fytyrë burri

Brezit tim; rinisë së Shqipërisë në 45-Vjetorin  
e Partisë

## P O E M E

### I.

Fytyra ime s'ka enigma. Është fytyrë  
burri.  
E pafshehur kurrë,  
e pambuluar edhe në gjumë,  
me sytë që ruajnë në të gjitha stinët  
ajrin e kthjellët të marsit  
dhe me lëkurën e vet të hollë si cipë  
ujërash,  
ç'ka për të thënë për kohën dhe njerëzit  
e thotë.

Ndaj ftyra ime s'ka enigma,  
s'e njen vuajtjen nga mbytja e fjalës  
në gjoks.

(E inem:  
jrymëzimi i pafat  
vdekjen Migjenit më shumë se gjithçka ia  
afroi,  
sepse aty ish koha me sterrimin e plotë të  
saj.

Hapësira e poetit  
ish për fluturime të mëdha, të bukura,  
për dashurinë e brishtë

që e lodh padurimi i pritjes,  
po s'e vret dot plumbi.

Eshtë e natyrshme, as i madhi Migjen  
kufomat e këngëve të pakëndueme  
s'mund t'i mbante gjatë në vete;  
s'ka gjë më të rëndë, më makubre  
se kufomat e këngëve).

Ftyra ime  
— fole e frymëzimit me fat —  
njerëzisht trishtohet në dhimbjet njerëzore  
ashtu si gëzimeve njerëzore  
njerëzisht u jepet.

Jo mosha, se mosha ka cak,  
para jush rininë time  
me këtë frymëzim e mas;  
aty është magma  
që koha ma mban përherë të zjarrtë.

*Aty fjala ime merr udh n e vet.*

*Fjala e thënë, fjala e thënë deri në fund  
është statujë madhështore e lirisë,  
statujë-simbol i ëndrrës më të lartë  
të njerëzimit,  
në të ështëjeta vetë  
që nga ulja e shpenguar në sofrën e bukës  
deri te diskutimi popullor i Kushtetutës.*

*Statujë madhëstore, statujë tragjike,  
mijëvjeçarët e vendit tim t'u bënë theror  
dhe populli me kështjellat e veta,  
arat,*

malet,  
me köngët ku ruante të mos ia rrëmbenin  
të fshehtën e ringjalljes,  
sepse dhei s'e treste besën e pambajtur  
të birit për nënën,  
me nuset shtatzëna, shtojzovallet  
t'u bënë theror ty, statujë e lirisë sime, —  
mundësi e fjalës për t'u thënë pa u vrarë  
me heshtje  
as me krisma pushkësh.

*Kur erdha në jetë,  
unë të gjeta në këmbë.  
Që ditën e lindjes  
fytyra ime qëndroi para teje,*

*t'u dha e tëra,  
t'u bë dritë,  
premtim gjaku i ëndrrës së prindërve,  
gjyshërve,  
premtim i ëndrrës së përtërirë të  
dëshmorëve  
  
të cilët, vite më parë,  
kur vetë nëna ime jetime  
ishte çupë një pëllëmbë  
dhe pas betejave të partizanëve  
brinjave e përrenjve mblidhë  
gëzhojat e pushkëve  
e lodra të çuditshme shpikte me to,  
ata ma kishin shkruar që atëherë  
me të kuqe në ballë  
amësinë e të gjitha ditëve që më prisnin,  
sigurinë se do të bëhesha edhe vetë baba,  
pastaj gjysh e stërgjysh,  
më kishin shkruar në ballë: 8 Nëntor 1941.*

*Unë të gjeta në këmbë, vërtet.  
Po s'erdha te ti si vizitor kureshtar,  
as nuk të mora pas në jetë  
si kujtim të rrallë.  
  
Ti ishe gatitur për mua,  
unë linda për ty —  
jemi Një.*

*Të falem, statujë e fjalës së lirë të rinisë,  
fytyrën time,  
fytyrën e mrekullueshme të brezit tim,*

këtë fytyrë pa enigma, pa mundime të  
ta jap për emblemë.

## II

Fytyra ime, fytyra jote, e dashur, fytyra  
ku singjeritetin kurrë s'na e morën jonë,  
rri përballë njerëzve, thashë, e pafshehur  
dhe vendos e para lidhjen time me ta.

Jo si ambasadore, gjithnjë e merakosur  
për të gjetur gjithnjë saktësisht fjalën e  
(gjuajtësit e gabimeve të mia të pafaj  
s'i mbuloi me lavdi koha ime,  
as etiketë,  
fytyra ime s'ka asgjë për të hedhur në  
Thashë, fytyra ime, fytyra jote e plotë, e  
fytyra jonë  
lindi në kohën kur mund të jetë  
deri në fund e singertë.

Dhe kjo s'është pak.  
Nuk është pak të mos tretesh prej frikës,  
kur nga çasti që vjen nuk dihet se ç'pritet,  
të shkosh rrugës pa i fshehur duart as sytë  
nga ajri as nga njerëzit  
që të kalojnë në krahë,  
të kesh përzënë prej vetes hijen e verdhë  
të servilizmit  
dhe shtirjen,  
me fjalën «hierarki» të qeshësh me përbuzje  
si me fjalën «zotni», «zonjushe»;  
nuk është pak  
të mos puthesh prej buzësh që s'të duan me shpirt  
dhe as të mos puthësh kërrkënd  
që, sa të ndahet prej teje,  
me shpinën e dorës të fshijë  
gjurmën e ngrohtë që buzët e tua aty  
kanë lënë.

ndërsa èndërrojnë të shkruajnë në ballë të  
njëri-tjetrit  
me gishtin delikat të të dashuruuarit  
oraret e fshehta të takimeve,  
takime ku asnje komplot e intrigë nuk  
thuret  
si në bisedimet e fshehta të presidentëve,  
nëse edhe aty flitet për armët atomike,  
luftën e yjeve,  
kjo do të thotë  
se ka njerëz që i janë përkushtuar  
deri në pikën e fundit të gjakut  
pavdekësisë sate, moj botë;  
të shkruajnë emrin e atdheut të tyre,  
psh Palestinë apo Kili,  
të shkruajnë moshën  
jo për të zëvendësuar kontrollin brutal  
të letërnjoftimeve  
në të gjitha udhëkryqet,  
por që ta shohin nënët  
dhe në mbrëmje vonë,  
me buzë të dridhur prej gazit të brendshëm  
t'ua tregojnë baballarëve,  
të shohin dallëndyshet e kthyera nga larg  
(ndoshta edhe nga vendi im),  
dhe lulet me petalet e djegura si qerpikë  
demonstruesish  
nga tymrat e bombave lotsjellëse,  
ta shohin gurët e bardhë të shtëpive,  
dhe drurët ku djemtë mbështesin butësisht  
rrugët  
shpatullat

që të mos u merren kömbët  
në çastin e shkurtër të përqafimit me  
vajzat.

Thashë, fytyra ime, fytyra jote, e dashur,  
fytyra jonë  
lindi në kohën  
kur mund të jetë deri në fund e çiltër.  
Pra, kjo s'është pak,  
fytyra më lidh e para me njerëzit e mi,  
u bëhet gjëzim në gjëzimet e tyre të shumta,  
në dhimbje u bëhet kurajë,  
ashtu si mijëra fytyra të bucura, përditë,  
mbi fytyrën time, mbi fytyrën tënde të  
plotë, e dashur,  
gazin e paçmuar e shtojnë bujarisht.

Në nusërimin e vet burrëror para botës  
fytyra s'duron,  
më tradhton edhe atëherë kur mendoj se  
s'duhet,  
llogaritë e vogla meskine m'i prish;  
ndryshe nga dora, nga fjala  
njeriut të poshtër s'pranon t'i jepet asnje  
çast.

Ndaj,  
me të jam grindur shpesh,  
e kam marrë më shpesh inat  
dhe pastaj,  
burrërisht ia kam ditur gjithmonë për nder.

Pasqyrë për ty kam sytë e bashkëkohësve,  
fytyra ime,  
pasqyrë besnike e ndershëmërës sate.

Kur ata janë të kthjellët,  
të qeshur në përshëndetje  
unë e di, kanë parë veten te ti,  
në rrudhat e imta,  
të porsashtrira përgjatë ballit,  
kanë lexuar metaforat e pashkruara ende  
të vargjeve të mia të lira,  
metaforat me dritë të vargjeve të mia të  
çliruara.

Aty, sy për sy me mua, i kanë thirrur së  
nesërmes  
nga padurimi ta lajmërojnë se unë, ti, e  
dashur,  
ne, bijtë e autorëve dhe personazheve të  
këngës «Dalëngadalë po vjen behari»  
për beharin që erdhi siç e deshën ata  
shkojmë me miliona këngë ngarkuar;  
e nesërmja vetëm pentagramet të bëjë  
gati.

(Lajmërojeni:  
s'është fjala për fletore të zakonshme  
muzike,  
ne, këngën tonë,  
mbi projekte gjigante kombinatesh e  
shkruajmë,  
mbi projekte hidrocentralesh e qytetesh  
të bardha).

I betohemi në nderin e tërë limonave e portokajve si diej  
të bregdetit, në nderin e Rrugës së Rinisë që, si motër e madhe, e paplakur kurrë,  
u prin në ngjitje, u vë emrin e vet në krye  
tërë rrugëve tonë në mal e në fushë,  
nëpër hekurudhave.

nëpër të cilat ka 40 vjet që udhëton,  
rend e s'lodhet  
gëzimi i ëndërruar i Shqipërisë,  
në nderin e tymit të kaltër të uzinave,  
në nderin e pikës së rëndë të lotit  
ditën që u ndamë me Enver Hoxhën,

në nderin e pëshpërimave tonë në veshin  
e vajzave  
mbrëmjeve  
nga droja mos trembam yjet dhe rrënjet  
e luleve,  
se në të gjitha këto është nderi i fytyrës  
sonë  
të burrëruar,  
i betohemi të nesërmes në atë nder të  
shenjtë  
se shkojmë drejt saj si lumenjtë drejt detit,  
të palodhur  
e pas çdo hapi më të mbushur.

*Fytyra ime,*  
e denjë të rrish përballë njerëzve të mi,  
përballë historisë së tyre të lashtë  
dhe përfytyrimeve që kanë për të ardhmen,  
fytyrë e denjë  
të ngjitesh në tribunën e Kongresit të  
Partisë,  
burrërisht të dëgjosh, burrërisht të japësh  
fjalën.

*Fjala jote me peshën specifike të mendimit  
komunist  
nga lartësi e asaj tribune  
vitet e ardhshme i afron e u thotë:  
«Sipas urdhrit suprem të Partisë  
ju do të bëheni të tëra begati e Shqipërisë.  
Urdhri i saj është urdhër i historisë,  
nuk bëhet dysh».*

### III

*Fytyra ime e pafshehur kurre,  
e pambuluar edhe në gjumë.  
Dua ta pyes ç'e mbron,  
ç'ia ruan lëkurën e hollë  
e sytë e kthjellët  
sot, kur botën më shumë se githçka e  
shëmton  
dhunimi i fytyrës së njomë të rinisë*

vetëm që ajo të ketë vështrim të turbullt,  
vetë koha të rrjedhë e turbullt aty,  
ashtu e turbullt të ikë në pakthim.

*Unë dua tē di fytyrēn time ç'e mbron.*

## Zéri i parë:

## Zëri i dytë:

*Gjyshi yt, që edhe kur po vdiste urdhëroi ta nxirrnit në oborr.*

Ish e vogël shtëpia, tepër e vogël  
lamtumirën e tij prej gjyshi burrash  
s'e nxinte dot.

Burrërimin tënd, të vellezërve e shokëve  
të tu  
ai s'e mati si dikur  
me sa herë dridhen mustaqet nën buzë,  
i mjaftonte nxitimi yt i mëngjesit  
për të shkuar në punë  
dhe qetësia e çlodhjes kur ktheheshe nga  
puna.

Ai iku dhe të la për fytyrë  
mësimin e jetës së vet:  
«Puna është nderi dhe lavdia e burrave.  
Mos ardhë kurrë puna te ti,  
tërë jetën shkofsh ti te puna!»

Zëri i tretë:

C'ndien  
kur me burra të panjohur përshëndetesh në  
rrugë  
dhe, për të mos mbetur prapë të panjohur,  
të thonë, duke tundur kokën me flokët e  
thinjura:  
«Ti je biri i filanit,  
babanë tënd e kam shok».

Në fytyrën tënde kanë parë tiparet e tij.

Babai, për të cilin në të gjitha fletanketat  
dhe dokumentet personale  
me krenari të pafshehur ke shkruar:  
Anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë.

**Zëri i katërt:**

E dashura jote, vajza me sy të blertë,  
ruan në krahororin e vet  
të fshehtën e kthimit të dimrit në pranverë  
dhe të pranverës  
në vjeshtë.

Jo se ka trill të luaj me stinët,  
ajo stinëve u jep vajzërisht jetë.

Dhe ti vetë kur i the: «Të dua»,  
i the: «Tani bota u bë dy herë më e madhe,  
dhe më larg do t'i shtyjmë kufijtë e saj  
nesër, pasnesër,  
jemi bashkë,  
jemi të paepur  
siç janë vetëm njerëzit lirisht të dashruar».

**Kori prej mijëra zërash:  
(refren)**

*Ti erdhe në jetë në një kohë të re  
kur çdo gjë kish marrë emrin e saj,  
toka-tokë, liria-liri, gëzimi-gëzim  
dhe vaji, sado i dhimbshëm, vaj.*

*Ti erdhe në jetë kur e vërteta kish fituar,  
shtegu i triumfit të saj ish çelur  
për të mos u mbyllur më kurrë.  
Ti shkove tek ajo për t'u bërë martir  
e zot i përjetshëm  
dhe asgjë në jetë veç së vërtetës nuk të  
bën burrë.*

*E vërteta të mbron. Rroftë e vërteta!  
Rrofshin burrat që i bëhen mburojë!  
Me faqe të dirsur, me faqe të padirsur,  
me faqe të vrarë nga puna e moti  
këta burra dheu të rrojnë!*

*Sepse koha do fytyrën e tyre,  
do syrin e tyre t'i shpojë tejembanë  
gjithë vjetërsirat, burokracirat,  
nga zemra e tokës në qiell të ndihet gjëmimi  
i gjakut që në deje kanë.*

Unë e di, e di, e di  
ku 'e merr pavdekësinë fytyra ime  
dhe rri e pafshehur kurre,  
e pambuluar edhe në gjumë.  
Sepse edhe në ëndrrat e mia më intime  
është dita që vetë ia bëra ceremoninë e  
përcjelljes  
pa asnje brengë pendimi,  
është dita që vjen nëpër udhën që i kam  
çelur vetë.

Nëntor, 1986

## E Bukura e Dheut

Ua di për ndër të parëve të mi  
që mundën të të ruajnë në jetën e tyre.  
Të bënë një shtëpi me dërrasa pishe në pyll  
dhe netëve të zeza të ruajtën prej shtrigave.

Të mbajtën këtu, në tokën e tyre, mbi  
dheun e murrmë  
në atë kohë  
kur gjithçka pasqyrohej përdhunshëm  
në qelqet e pallateve të rreme të qiejve.

Ata të rrëmbyen nga mosqenia,  
të dhanë fryshtën e tyre të ngrohtë  
e të shenjtëruan si grua,  
ua di për nder!  
Ndryshtë s'do të njiheshim bashkë,  
s'do dashuroheshim  
sikur në vend të emrit që ke, të quheshe,  
për shembull:  
E bukura e deteve apo e qiejve.

## Tregim

Ecin në rrugë gjyshi me nipin e vet  
përdore. Nipi serioz,

gjyshi me një gaz vallëzues te sytë.

— Tani, o gjysh, — thotë nipi, — e dua  
barin magjik që të bën burrë.

Gjyshi dëgjon dhe hesht

me gazin vallëzues te sytë.

— Prit, — i thotë —

më duhet edhe pak kohë.

Prit!

Të shoh si do të dalë burrërimi i tyt eti  
tani që ka në duar jetën.

Në barin që do marrësh ti

të heqim ç'nuk i ka bërë mirë atij.

Atë çast unë pata dëshirë

të njihja babanë e djalit, të mësoja:

ëndrrën për t'u bërë burrë

ai apo gjyshi ia kishin zgjuar së pari?

Fëmija me gjyshin ecin në rrugë.

Për të mos rënë,  
mbajnë njëri-tjetrin përdore.  
Tutje, në furrën e ndezur të perëndimit  
gatuhet bronzi  
për burrat që do t'i meritojnë statujat.

## Frika e gënjeshtërt

Në m'u ndaltë një ditë zemra  
dijeni, as nga sëmundja s'ka ardhur,  
as nga pleqëria.

Në trupin tim të fortë,  
të rrahur nga dielli e era,  
vdes vetë vdekja.

Por, u bënë kaq ditë që trembem,  
trembem se nga çasti në çast  
do të më ndalet zemra.

E pra, as sëmundja s'ka ardhur,  
as pleqëria.  
Druhem se zemra ime e vogël  
do të harrojë të rrahë,  
ajo, e shkreta,  
e hutuara nga dashuria.

# Burokrati

(karikaturë)

*E thirri vartësin dhe i tha:*

*— Të pres në zyrë pas gjysmë ore.*

*Pas gjysmë ore,*

*fiks,*

*vartësi qe aty.*

*Me sytë tretur diku larg*

*tha shefi prapë:*

*— Në njëmbëdhjetë kemi mbledhje:*

*Tani në punë,*

*mos humbni kohë!*

## Në njëmbëdhjetë

të tërë u mblodhën  
për t'ua kujtar edhe një herë  
të përgatiteshin me shkrim  
për mbledhjen që do bëhej  
nesër.

# Në malet e Jugut

Atje ku kam lindur malet janë ndryshe.

Vërtet të rënda,

vërtet të larta,

me majat në re,

po unë fëmija luaja me to,

u ndërroja vendet,

i ulja,

i ngrija;

me bjeshkët përditë

unë krijoja gjeografinë time të re.

Dhe malet këtu të tëra i kanë:

po aq të rënda janë,

po aq të larta,

bujarisht i presin e përcjellin miqtë

e prapë mua s'më ngjajnë —

para tyre jam e s'luaj dot me to,

nga vendi dot nuk i lëviz.

Ngaqë s'jam më fëmijë?...

## Nëna

Nëna, e heshtura,  
shkon e nga shkon, por prapë aty është,  
në ajrin që duket dhe s'duket njëherësh,  
në rrembat e gjakut tonë, në zemër.

Në rrugët ku hyjmë, të mëdha e të vogla,  
kudo shkojmë,  
                        kudo ecim,  
para se të vëmë këmbën ne,  
sa mban  
e provon këmba e nënës.

Aty ku mund të na shfaqen sirenat  
na zë veshët,  
aty ku duhet të tendosim harkun,  
                        të marrim në shenjë  
na bëhet forcë dhe mëri.

*Odiseja, vëllai im ballkanas*

*tremijëvjeçar,  
në mirën johje ndaj Athinasë,  
i falej Olimpit tē zbrazët.  
Më dhimbset, s'arriti kurrë ta kuptojë se  
qe nëna,  
u kthye në Itakë, jetoi e vdiq edhe vetë  
pa mbjellë një lule që s'thahet  
te varri i saj.*

## Antifetare

Sikur në vend të Krishtit e Muhametit  
në Bibël e Kuran  
të përshkruhej fati tragjik  
i dashurisë së Tristant dhe Izoltës,<sup>1)</sup>  
njerezit e mirë,  
banorët e pavdekshëm të rruzullit tokësor,  
do ta kishin shumë të vështirë ta përzinin  
prej vetes  
idenë e zotit.

---

1) Personazhe të një legjende të njojur mesjetare  
panevrropiane, ku tregohet për dashurinë që nuk e  
ndan dot as vdekja.

# Elegji për të rënët nga bora

Me ç'ju ngjau bora atë çast?  
E deshët a e nëmët bukurinë e saj të  
bardhë?

Thonë se vdekja vjen ngadalë,  
ta tregon dhe një herë përrallën e jetës,  
të mban dhe një herë te gjërat e bukura,  
(e unë prapë ju pyes:  
— Metaforat e borës ju erdhën ndër  
mend?)  
të çmallesh e të mallesh  
me dashuritë e shkuara.

Thonë... Po ju vetë pse s'thoni një fjalë?  
Kë deshët më shumë t'ju vinte pranë?  
Gruaja?  
E me kë do rrinin fëmijët?

Fëmijët?

Të mirët, si do dilnin jashtë në atë ngricë?!

Shokët?

Shokët le të vijnë, kur të qetësohet bora.

Kur ju nuk folët, fola unë për ju.

Thashë:

— Ata shkuan te vdekja pa dashur,  
s'u qe bërë jeta barrë, jetën e deshën,  
ndaj s'ndenjën dot brenda se nuk duruan  
që jeta të ligej, të merrte plagë.

Thashë:

— Vdekja u erdhi krejt pabesisht,  
s'i theu dot, s'i mundi  
t'i bënte ta nëmnin bukurinë.  
Gruan, fëmijët e shokët s'i thirrën,  
nuk donin vdekjes t'ia sillnin pranë.

*Ju më dëgjuat e nga poshtë,  
atë çast  
me dritën e syve të pambyllur  
shkritë borën përqark.*

**Janar, 1985**

# Etyd i vogël për shpatën e rëndë të Gjergjit

... Dhe thonë se shpatë e Gjergjit ish e  
rëndë,  
e rëndë sa pesë burra të sotëm s'e ngrejnë  
njëherësh.  
Ne e besojmë, e besojmë, patjetër ashtu ka  
qenë,  
dimë ç'nyjë e historisë u desh të këpuntej  
me tehun e saj...

# Pishat nëpër rrugët e kryeqytetit

Shtëpitë — me gurë e gëlqere të bardhë,  
çatitë — me tjegulla prej baltës së kuqe,  
trotuaret — me pllaka çimentoje gri;  
nga të qëndruarit gjithnjë në shi e në  
diell,  
bronzi i statujave është bërë i platintë.

Në anë të rrugës, pishat e blerta,  
me gishtérinjtë delikatë të halave,  
shpupurisin lehtë flokët e kalimtarëve  
në këtë mesditë të zakonshme dimri.

Që nga sytë e njerëzve, me të blertën e  
butë  
pishat ngjyrosin tërë peizazhin,  
shkruajnë mbi të biografinë e vet,  
tregojnë të fshehtën që i shtyu të zbresin  
nga mali.

# Vargje për karrigen e burokratit

Dru i shkretë,  
dikur ka qenë plep!

Ke pasë një diell që të ngrohte  
dhe një fole ku mblidhje zogjtë;  
ke pasur erë, ke pasur shi  
dhe vit për vit nga një pranverë,  
dhe vit për vit nga një vjeshtë.

Atëherë, atëherë kur ishe plep!

Tani nën dritë llambë neon,  
ti, dru i lyer me bojë të verdhë,  
i ngrohur me calorifer  
nën peshë burri 70 kile.  
në mbledhjet e gjata kërcet.

Dru i shkretë,

mbi ty u shkua një copë jetë,  
ai burrë u bë dhe me pak bark,  
harroi shumë gjëra që kish pasur.

Po ti, po ti nuk munde, jo  
të ngrije zënë,  
t'i thërrisje: «Ç'bën?».

Oh! Kishe harruar edhe vetë  
se dikur ke qenë plep!

## Trilli i një dite janari

Si të të sjell pranë tani që kam mall?  
Ka rënë borë e madhe sa dhe rrugët janë  
zënë,  
bën ftohtë sa dhe zogjtë tremben të dalin,  
frym erë sa dhe pemët duan t'i fshehin  
degët,

Po unë të dua tani e vetëm tani.

Në s'ardhsh, di vetë si të të sjell:  
Do dal jashtë, do mbledh borë,  
unë që s'gdhend dot në gur të fortë,  
në borë me një gisht fytyrën tënde e  
gdhend.

Nga inati që s'erdhe vetë,  
do të rri sa të çmallem një çast  
pastaj do të të lë vetëm, atje, në oborr.

*Por, ah! E di, që tani e di,  
inati im do të të bëjë edhe më të bukur;  
era tërë natën do të t'i krehë flokët,  
ngrica do të të bëjë me sy të jeshiltë.*

*Unë prapë po të them, nga inati i madh,  
do të shkoj të fle, të më ngrohë një ëndërr  
që e di, nesër do ta sjell ty,  
të ta jap e të të bëj me shpirt.*

## Motra

*Shoku do e s'do tē mē thotë diçka:  
Motra shpesan vjen pak e hutuar brenda,  
kérkon një hije tē vogël  
që s'ia jep dot dhoma  
tē fshehë fytyrën e skuqur.*

*Gjen një punë tē papunë  
me shpinë nga ne  
e s'thotë një fjalë.  
Druhet mos e trembë fluturimin e zogut  
që sapo i la mbi buzë i dashuri i saj.*

*Unë që s'kam motër  
mendoj për tē dashurën time me vëlla.*

## Grupi artistik i minatorëve

*Dikush u tha tē dilnin nē skenë  
me rrobat e punës,  
tē ndiznin llambën e karbitit nē ballë.*

*Po ata thanë:*

— Rrobot i veshim ne, jo kënga, jo vallja,  
minatorë s'na bën llamba e karbitit,  
s'na bën mushamaja.

Nëse vetë kënga s'ndizet nga zemra,  
gjithë dinamitin të mblidhnim  
s'do të mund të shtonim një tingull atje.

*... Dhe zgjodhën rrobat më të mira.*

## Pleqtë

Veshur me çorape të trasha leshi,  
prapë te këmbët kanë ftohtë.  
Dhe shajnë zjarrin, drutë e lagura  
që të mos përmendin moshën.

Dhe bash atëherë kur e ndiejnë më fort  
të ftohtin e këmbëve, reumatizmën e  
gjunjëve  
nuk e di pse kanë dëshirë të flasin  
për rininë e tyre  
dhe tregojnë më bukur se kurre.

# Mësimi im i parë për luftën

*Kuptimi i kësaj fjale hyri në jetën time  
kur ende s'e dija shkrimin e leximin e saj.  
Dora e këputur e fqinjit tim të plakur...*

*Pas tingujve të saj  
si pas kolonash të padukshme  
më fshiheshin ata gishtërinj që s'i pashë  
kurre  
ë prej andej më flisnin, më flisnin  
me një gjuhë të ashpër si kockat e thyera,  
kur ende fjala s'e sillte dot tek unë  
dhimbjen,  
më flisnin, më flisnin.*

*Aty mësova se ka njerëz në botë  
që për gjakun mendojnë si për një pellg uji  
në rrugë;*

me po atë lehtësi, me po atë shpërfillje  
mund të qeshin, të luajnë,  
duke u tallur me të, ta derdhin  
e prapë të luajnë, e prapë të qeshin.

Se ka njerëz të tjerë  
që përpara gjymtimit tragjik të botës  
vënë gjymtimin e dhimbshëm të trupit të  
tyre  
e bota të ecë,jeta të ecë  
mes dhimbjeve e gëzimeve të njerëzve të  
shtrenjtë  
duke flakur jashtë çdo çast e çdo ditë —  
armiqtë.

# Ëndrra vajzërie

1.

Ditët janë pikla dielli,  
netët janë pikla hëne.  
Në dritën e tyre

si në një pasqyrë të paanë  
duket e zhduket një fytyrë.

E unë bëj ta njoh,

e unë bëj ta njoh!  
Ka diçka prej meje të balli,  
te buzët,

tek ëndrra,

te sytë.

E unë bëj ta njoh,

e unë bëj ta njoh,  
fytyra ime është a fytyra e atij?!

2.

*Do të vijë ai nëpër një rrugë të gjerë,  
të gjerë.*

*Prapa tij do lëvizë horizonti  
me malet, me fushat, me lumenjtë e lehtë.  
Se a mund të vijë ai ashtu, thjesht?!*

*Mbi flokët e tij,*

*mbi duart e tij  
do të zbërthehen gjithë ngjyrat e qiellit,  
do ta bëjnë një çast të padukshëm  
të mos më shohë mua të skuqur.*

*Do të vijë ai nëpër një rrugë të gjerë,  
të gjerë  
ku unë s'kam shkelur kurrë.*

3.

*Do t'i them... Ç'do t'i them?*

*Ai i njeh më parë fjalët e mia,  
të tëra mendimet e mia i njeh.*

*Dhe pse kurrë s'më ka parë,  
dhe pse kurrë s'më ka folur  
ai të gjitha të fshehtat e mia i njeh.*

*Do t'i them...  
Ç'do t'i them?*

*Oh! Po si t'i them?*                            *Ku e paskam pritur?*  
*Si e paskam pritur*                            *kur ka qenë me mua?!*

## Dritat nëpër rrugët e qytetit

Qyteti fle  
me dritat e rrugëve ndezur,  
si sy grash të posaputhura me burrat  
që s'kanë gjumë nga dëshira t'i shohin  
si flenë ata  
me fytyrën e tyre nëpër ëndrra.

Qyteti fle  
me dritat e rrugëve ndezur.  
Rrugët,  
rrugët s'flenë dot  
nga malli për njerëzit.

## Kushtim rilindësve

*Nata dhe dita mbërthyer keq  
në dy brirët e hollë të dhisë.*

*Çfarë drite kish dielli mbi kokën tonë?  
Nga lindja na vinte ashtu, krejt i zbehtë  
dhe skuqej kur ikte në perëndim.  
Mbi kokën tonë, mbi kokën tonë  
çfarë drite kishte?*

*Dita dhe nata, vera dhe dimri  
hutuar nga sytë e ligur të njerëzve.  
Shtëpisë nga duhej t'ia kthenim dritaret,  
nga lindja e zbehtë  
a perëndimi i përflakur?*

*Kështu, ditë pas dite  
çoroditjen shekulli po e linte pas.  
Burrat s'kishin kohë ta vrisnin me fjalë.*

Burrat u nisën për Fushëkosovë.  
Me hapin e tyre të rëndë  
si mbi barin e djegur të verës, shkelnin  
mbi vendimet e zeza të supershteteve.

Shqipëri! Shqipëri!  
Sa mundim t'u desh  
të shkundje nga supet pesë shekuj të rëndë,  
shekulli i ri të të gjente në këmbë!

## Djali im sot pa detin për herë të parë

*Djali im sot pa detin për herë të parë:  
Nuk di me ç'i ngjau, por, nga stepja,  
harroi dhe dy fjalët që kishte mësuar.  
I ngurtësuar në krahët e mi qëndroi,  
qëndroi gjatë.*

*Dhe kur, më në fund,  
ndjeu nevojën të thoshte diçka  
i doli veç një dridhje e lehtë buzësh.  
Ktheu kokën nga unë  
e nisi të qajë.*

*I desha lotët e tij, s'e pajtova, e lash në  
vajë.  
S'ishin lot si përherë, ishin lot inati.  
Djali im —*

foshnjë që ende s'është ngritur në këmbë,  
paska sy të hahet me detin,  
me jetën dhe me vdekjen do të ketë sy të  
hahet.

1984

## Dimërimi i dhenve në vendlindjen time

*Nata e gjatë e dimrit,  
nata e verbuar me stuhi dëbore  
më shumë se për këdo është pak e  
trishtuar  
për fëmijët e urtë të barinjve.*

*Ata kërkojnë në shtëpi atin  
të urdhërojë gjumin t'u zbresë në qerpikë,  
kërkojnë nënën,  
motra e madhe u shtron darkën;  
motra është e mirë po s'bëhet dot nënë.*

*Fëmijët s'bërtasin, s'vënë kujën: «Ku  
janë?»  
e dinë, babai me nënën, gjithë natën me  
cikmë,  
dhenve që s'i ngroh më dot lëkura e tyre,  
ua mbajnë ndezur zjarrin.*

*Sikur një natë, papritur, babanë e nënën  
t'i zinte muzgu në shtëpi,  
të parët do të pyesnin vetë fëmijët:  
«Me kë i latë dhentë? Mos na ngrijnë!»*

*Kaq mund të thonë ata burra ende të  
mitur  
— zbutësit e ardhshëm të furisë së natyrës.  
Tani për tanë, sa për të thirrur gjumin,  
i tregojnë njëri-tjetrit  
përrallat e lexuara në libra.*

# Këngë e vjetër tropojane për vahet

*Edhe lumi e ka ditur  
se njeriu, kur rri pa njerinë,  
bëhet varri i jetës së vet,  
edhe lumi e ka ditur.*

*Edhe mali e ka ditur  
se njeriu duhet të shohë përtej majës së tij,  
ta ndiejë veten gjallë në jetën e të  
tjerëve,  
edhe mali e ka ditur.*

*E kanë ditur mali e lumi  
e janë hapur te vahet.*

Një ditë me borë  
të madhe

Fantazi poetike

*Bora mbuloi catit  e majat e pem ve.*

*Mbështjellë me mjegullën e lotit të mallit  
stërnipërit më vunë në krah të gjyshit,  
në hirin e vatrës,  
se ne, pleqtë e lashtë,  
dimë t'ua mbajmë ndezur zjarrin.*

## Zgjimi

*Doli hëna*

*e zgjoi gjethet e plepit,  
gjethet zgjuan zogjtë,  
zogjtë zgjuan barin,  
bari zgjoi gurët e bardhië të rrugës.*

*Gjithçka lëvizi,*

*gjithçka u bë dritë.*

*Ku e ndienë? — pyete ti.*

*Ku e ndienë? — pyeta unë.*

*Ku e ndienë që ne erdhëm*

*me dashurinë?*

## Shote e Azem Galicës

Mes tyre hyri një qiel i lartë  
e nën tē toka me fusha e male,  
me grunjëra që digjen e vatra që shuhën,  
me ara tē pambjella, me ara tē pakorra,  
me fëmijë që s'kanë kohë tē jenë fëmijë,  
me pleq që s'kanë kohë tē thinjen krejt,  
me gra tē heshtura, tē heshtura, tē  
heshtura,  
me qe tē ligur nga mungesa e par mendës,  
me par mendë që u ndryshken dorezat  
nga mungesa e duarve tē djersitura tē  
burrit,  
se burrat, burrat me hapin e tyre  
kapércejnë ditët, kapércejnë netët,  
kapércejnë vdekjen e vet tē tmerrshme,  
kapércejnë vdekjen më tē tmerrshme —  
vdekjen e kombit,  
e me gjakun e zemrës lidhin kohërat.

*Fjala e saj për të shkuar tek ai  
përshkoi tërë këtë hapësirë Shqipërie,  
nëpër tërë këtë hapësirë rendi e thirrura e*  
*tij;*

— *Ja ku jam, po të pres!*  
*Me një zë iu përgjigjën njëri-tjetrit...*

# Fleta e urdhër shërbimit

Shokëve të mi gazetarë

*Fletë e bardhë,  
këputur nga ky qiell janari,  
krejt e largët, e ftohtë,  
pa një pikë romantike për syrin.*

*S'më pyete në kam dëshirë të nisem;  
për ditët që do të mungoja  
s'i the gruas sime si do rrinte pa burrin,  
s'i the djalit tim si do të rrinte pa babin,  
kur më nise për rrugë;  
përulësisht kurrë s'ua qave hallin.*

*S'kanë hall për t'u qarë, më përgjigjet  
poeti.  
Kështu më nise gjithnjë  
dhe më nis prapë për udhë,  
pa lutje, përgjërimë.*

Fletë e bardhë,  
këputur nga ky qiel i sotëm janari,  
të mbaj në dorë,  
nuk më je më e huaj  
qëkur mbi ty,  
nën fjalën «urdhër».  
është shkruar emri im.  
**Urdhër!**  
Asnjë çast s'kthehem mbrapsht.

## Zogjtë e diellit

*Ra bora e madhe, na zuri best.*

*U mek e hutuar krejt bota pérreth.*

*Të pamagjepsur mbetën vetëm zogjtë,  
shkonin e vinin si infirmierë.*

*Në sqepin e tyre të verdhë  
ruhej imazhi i ngrohtë i diellit të verës;  
në të mbahej dita të mos këpuntej në mes.*

## Bisedë me djalin për macen

Jashtë bie borë, bie e s'ndalet.

Shihe, shihe, vogëlush, macen tënde,  
(kjo që do të them tani nuk është gjë a  
gjëzë):

A s'është gëzofi i saj më i buti gëzof?

Atëherë përse  
edhe më shumë se ti e se gjyshja e plakur  
ajo paska të ftohtë?

Hë, pse ndodh kështu?  
Po të pyes tani e m'u përgjigj kur të  
rritesh.


## Motiv i lashtë popullor për shpirtin e paepur

O ju korba që më hani, oi, oi!  
Nën këtë qiell të kthjellët,  
nën këtë qiell të kaltër,  
pa nënën, as gruan te koka,  
pa një shok për të më mbajtur për  
krahësh,  
oi, oi!

Kam trupin tim që ma çukisni ju,  
kam edhe honin e thellë të shpirtit;  
aty mbys dhimbjet.  
Se dhimbja del jashtë nëpër kokrrën e  
lotit,  
vini ju, m'i çukisni e më verboni.

*Me dritën e syve shëroj plagët  
e ngrihem rishtas të bëj tutje.  
Në krye të rrugës që kam nisur  
më pret e më pret ëndrra ime.*

*Dhe pa u takuar me të  
nuk mund të vdes.*



## PËRMBAJTJA

Abetarja .....	3
Unë jam pjesë e rrugës sime .....	4
Skicë nga një pasdite dimri në Kurbnesh .....	7
Këngë dashurie në vjeshtë .....	8
Lulet prej letre .....	10
Histori e Shqipërisë .....	12
Fjalë babai .....	14
Intime .....	16
Para pasqyrës .....	17
Të vërteta të thjeshta .....	19
Vdekja e gjyshit .....	20
Sot .....	22
Shkak për të dashur më shumë .....	23
Don Kishotit .....	25
Rritja .....	27
Edhe me ne si me të gjithë .....	29
Këngë për veten .....	30
Si fëmijët .....	33
Në rrugë .....	34
Gjimnazistja që shkruan vjersha .....	36
Motiv i përditshëm .....	37
Borxhi i babait .....	39
Teatri i kukullave .....	40
Fytyrë burri (poemë) .....	42

E Bukura e Dheut	
Tregim	
Frika e gënjeshtërt	
Burokrati	
Në malet e Jugut	
Nëna	
Antifetare	
Elegji për të rënët nga bora	
Etyd i vogël për shpatën e rëndë të Gjergjit	
Pishat nëpër rrugët e kryeqytetit	
Vargje për karrigen e burokratit	
Trilli i një dite janari	
Motra	
Grupi artistik i minatorëve	
Pleqtë	
Mësimi im i parë për luftën	
Ëndrra vajzërie	
Dritat nëpër rrugët e qytetit	
Kushtim rilindësve	
Djali im sot pa detin për herë të parë	
Dimërimi i dhenve në vendlindje time	
Këngë e vjetër tropojane për vahet	
Një ditë me borë të madhe	
Zgjimi	
Shote e Azem Galicës	
Fleta e urdhërshërbimit	
Zogjtë e diellit	
Bisedë me djalin për macen	
Motiv i lashtë popullor për shpirtin e paepur	